



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATURA E SHTETIT
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. 380/3 Prot.

Datë 05 / 6 / 2025

URDHËR

Nr. 330, datë 05.6.2025

**“PËR
PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR AVOKAT SHTETI NË
PROVININ E PRANIMIT TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS”**

Në mbështetje të neneve 6 gërma “a” dhe 20 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, të ndryshuar, Memorandumit të Bashkëpunimit të nënshkruar midis Avokaturës së Shtetit dhe Shkollës së Magjistraturës me nr. 380/2 prot., datë 10.02.2025,

URDHËROJ:

1. Miratimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për avokat shteti në provimin e pranimit të në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës.
2. Ky urdhër përcakton procedurën e verifikimit të kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës dhe verifikimit të figurës për kandidatin që kualifikohet në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për avokat shteti në nivel vendor dhe avokat shteti në nivel qendror.
3. Kushtet/kriteret e përgjithshme të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për avokat shteti në nivel qendror ose vendor, përcaktohen në nenin 20 të ligjit “Për Avokaturën e Shtetit”. Kandidati duhet:
 - a) të jetë shtetas shqiptar;
 - b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - c) të ketë përfunduar programin e formimit fillestar për avokat shteti pranë Shkollës së Magjistraturës;
 - ç) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;
 - d) të mos jetë shkarkuar nga shërbimi civil, apo çdo funksion tjetër publik, për shkelje ose paaftësi në kryerjen e detyrave;
 - dh) të gëzojë integritet moral dhe profesional.
4. Kriteret e veçanta të pranimit në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për avokat shteti në nivel qendror dhe vendor në Shkollën e Magjistraturës, janë:

- a) ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë “Master i shkencave”, ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë, referuar nenit 124 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”. Diplomimi i tyre duhet të mbështetet në përfundimin e një programi sipas sistemit të Bolonjës 5-vjeçar, ose të jetë diplomuar si “Jurist” me një diplome universitare të fituar para përshtatjes së studimeve sipas sistemit të Bolonjës në një program 4-vjeçar, e cila është ekuivalente me një Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë, (DIND)”;
- b) *ka notë mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë). Për të diplomuarit “Juristë”, në programe në gjuhë të huaj jashtë vendit, parashikohet një koeficient vështirësie i barabartë me 1.2, i cili do të përcaktojë mesataren e tyre faktike;*
d/1) Nota mesatare e përgjithshme del nga shumatorja e notave të të gjitha lëndëve të zhvilluara në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve e pjesëtuar me numrin total të tyre;
- c) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë si jurist, pas diplomimit në ciklin e plotë të studimeve universitare, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;
- d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që, për shkak të veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e avokatit të shtetit dhe dëmton rëndë besimin e publikut në administratën shtetërore dhe sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal;
- e) nuk është larguar nga detyra ose nuk i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- f) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;
- g) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;
- h) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete.

5. Objekt i verifikimit do të jetë:

- a) verifikimi i kushteve dhe kriterëve formale të emërimit “avokat shteti”;
- b) verifikimi i figurës.

Procedura e verifikimit të kandidatëve për në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës.

6. Procedura e verifikimit fillon jo më vonë se 7 ditë nga dërgimi prej Shkollës së Magjistraturës të listës së kandidatëve që kanë kandiduar për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për avokat shteti në nivel qendror ose në nivel vendor, si dhe të dokumentacionit mbështetës të paraqitur prej tyre.
7. Me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ngrihet një komision i përkohshëm për kryerjen e procedurës së verifikimit, i përbërë nga dy avokatë shteti në nivel qendror dhe një specialist të burimeve njerëzore ose jurist të Avokaturës së Shtetit.
8. Pas caktimit të Komisionit, kandidati njoftohet për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, për Kryetarin dhe anëtarët e komisionit, si dhe për të drejtën që ka për të kërkuar përjashtimin e tij dhe/ose të çdo anëtar tjetër të komisionit, jo më vonë se 3 ditë nga njoftimi ose nga marrja dëgjimi e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Në këtë rast, kandidati i dërgohet dhe

formulari deklarues për adresën elektronike për qëllimet e procedurës së verifikimit, të cilin duhet ta dorëzojë brenda 3 ditëve në zyrën e arkivit dhe protokollit në Avokaturën e Shtetit.

9. Verifikimi kryhet mbi bazën e dokumenteve të paraqitura nga kandidati në momentin e kandidimit. Dokumenti që nuk është në formën e kërkuar nga ligji, që nuk përmban të dhëna të plota, që përmban pasaktësi ose elementë që sjellin dyshime për vërtetësinë e dokumentit apo të përmbajtjes së tij, nuk merret parasysh për qëllimin e verifikimit. Përgjithësisht, Komisioni mund të kërkojë nga kandidati plotësimin e dokumentit që mbart mangësi.
10. Komisioni kujdeset për verifikimin e plotësimit nga kandidati të kriterëve ligjore të kandidimit dhe në veçanti për:
 - a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të nevojshëm të verifikimit;
 - b) përgatitjen e relacionit, ku përshkruhen veprimet e kryera dhe dokumentet e administruara gjatë verifikimit, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për qëllimin e verifikimit, duke i bashkëlidhur relacionit kopje të këtyre dokumenteve;
 - c) përgatitjen e projektvendimit përkatës të verifikimit;
 - d) njoftimet për kandidatin.
11. Komisioni, kur konstaton dhe vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga kandidati është i paplotë, njofton menjëherë atë për plotësimin e tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë.
12. Mbi kërkesën e kandidatit, kur i vlerëson të justifikuar motivet e paraqitura për mos përmbushjen në afatin e caktuar të detyrimit për plotësimin e dokumentacionit, Komisioni i cakton atij një afat të ri të arsyeshëm.
13. Bazuar në gjetjet e verifikimit, nëse vlerëson që mund të procedohet me skualifikimin e kandidatit, pasi vë në dijeni Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit, me vendim të këtij të fundit, Komisioni njofton kandidatin lidhur me gjetjet paraprake dhe dokumentacionin përkatës, si edhe për të drejtën që, brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë në rrugë elektronike dhe/ose në zyrën përkatëse të Avokaturës së Shtetit, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij. Në këtë rast, në pamundësi objektive ose për motive të tjera të justifikuar për të paraqitur qëndrimin dhe shpjegimet brenda afatit 5-ditor, kandidati njofton menjëherë Avokaturën e Shtetit, duke i parashtruar edhe motivet përkatëse. Nëse motivet vlerësohen të justifikuar, mbi kërkesën e kandidatit, Komisioni i cakton atij një afat të ri të arsyeshëm për të paraqitur qëndrimet dhe shpjegimet lidhur me gjetjet e verifikimit.
14. Në përfundim të verifikimit, Komisioni përgjatë relacionin mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm, duke ja dërguar menjëherë për shqyrtim Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit.
15. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij, Komisioni ndihmohet nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të kryetarit.
16. Kandidati fitues në provimin e pranimit në programin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, për avokat shteti në nivel qendror ose nivel vendor, i nënshtrohet verifikimit të figurës.

Procedura e verifikimit të figurës së kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës.

17. Jo më vonë se 3 ditë, nga ajo e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, kandidatit i dërgohet në rrugë elektronike:
 - a) formulari i vetëdeklarimit sipas Ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
 - b) informacion mbi lidhjen elektronike në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit, në të cilën kandidati mund të marrë dhe plotësojë sipas ligjit, në rrugë elektronike, formularin sipas shkronjës “a”, të kësaj pike;
 - c) formulari autorizues për Avokaturën e Shtetit, përmes të cilit i jepet e drejta për të kryer verifikime dhe për të kërkuar raportim, informacion dhe dokumentacion nga institucionet kompetente për verifikimin e figurës, gjykata, prokuroria, si dhe nga çdo subjekt tjetër publik ose privat, që mund të disponojë të dhëna mbi figurën e kandidatit.
18. Jo më vonë se 3 ditë nga dërgimi, në rrugë elektronike, i formularëve sipas pikës 17, të këtij urdhri, kandidati i dorëzon ato të plotësuara në zyrën e protokollit të Avokaturës së Shtetit.
19. Vetëdeklarimi i kandidatit sipas Ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kur është rasti, dërgohet në Prokurorinë e Përgjithshme nga kryetari i Komisionit, duke i kërkuar kryerjen e verifikimeve përkatëse.
20. Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, komisioni, në varësi të procesit konkret të kandidimit, kryen procedurat standarde si më poshtë:
 - a) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, formularët e deklarimit dhe vetëdeklarimit;
 - b) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, formularin autorizues për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga kandidati, këtë formular;
 - c) i dërgon kandidatit, në rrugë elektronike, formularin autorizues për verifikimin, pranë çdo subjekti publik dhe privat, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kriteret ligjore të kandidimit dhe merr në dorëzim fizikisht, të nënshkruar nga kandidati, këtë formular;
 - d) përgatit shkresat standarde për kërkimin e informacionit nga subjektet publike dhe private, si dhe të shpjegimeve përkatëse nga kandidati, në lidhje me kushtet dhe kriteret ligjore të kandidimit.
21. Të drejtat e kandidatit. Kandidati njoftohet menjëherë për fillimin e procedurës së verifikimit dhe, kur është rasti, për anëtarët e komisionit të verifikimit.
22. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesë, të njihet me dokumentet e dosjes së tij, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative.
23. Kryesisht, apo mbi kërkesën e Komisionit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kriteret me kandidimit të tij, si dhe të depozitojë, kur është rasti, dokumente shkresore në mbështetje të këtyre shpjegimeve.
24. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa nuk ka përfunduar procedura e verifikimit, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.

25. Afatet dhe llogaritja e tyre. Afatet në procedurën e verifikimit caktohen në ditë, në javë ose në muaj. Përfundimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike.
26. Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.
27. Afati i përcaktuar në javë mbaron me kalimin e asaj dite, që është e njëjta me ditën, në të cilën ka ndodhur ngjarja, nga e cila ka filluar të ecë afati.
28. Afati i përcaktuar në muaj mbaron me kalimin e asaj dite, atij muaji, që ka të njëjtin numër me atë të ditës, në të cilën ka ndodhur ngjarja nga e cila ka filluar të ecë afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit, afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji.
29. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.
30. Dita e fundit e afatit vazhdon deri në orën 24.00 të saj.
31. Njoftimet dhe kërkesat e Komisionit drejtuar kandidatit dhe anasjelltas, si rregull bëhen në rrugë elektronike. Ato konsiderohen të marra ditën e nesërme të dërgimit në rrugë elektronike.
32. Adresa elektronike e Komisionit i bëhet e ditur kandidatit me njoftimin e fillimit të procedurës.
33. Adresë elektronike e kandidatit është ajo e deklaruar nga ai për këtë qëllim pranë Komisionit.
34. Dorëheqja dhe përjashtimi për shkak të konfliktit të interesit. Kryetari ose anëtari i Komisionit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas ligjit *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e verifikimit të kandidatit.
35. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Komisionit vendos Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.
36. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e një anëtari të tij.
37. Për nëpunësit e njësisë mbështetëse të Komisioneve zbatohen dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Ligjit *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”* mbi paanësinë e administratës publike.
38. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtijshëm të figurës dhe integritetit të kandidatit, Komisioni mund të kërkojë:
 - a) informacione shtesë nga subjektet e përmendura në këtë urdhër;
 - b) shpjegime me shkrim nga kandidati.
39. Shkaqet për skualifikimin e kandidatit janë si më poshtë:
 - a) ka shfaqur sjellje serioze joetike ose mungesë të theksuar integriteti moral dhe profesional;

- b) është në kushtet e ndalimit sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
40. Skualifikimi i kandidatit sa i përket figurës vendoset edhe kur ai:
- a) nuk ka plotësuar ose depozituar formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
 - b) nuk ka depozituar, të nënshkruar, autorizimin për Avokaturën e Shtetit, përmes të cilit i jep të drejtën për të kryer verifikime dhe të kërkuar raportim, informacion dhe dokumentacion nga subjektet e përmendura në këtë urdhër, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij.
41. Në përfundim të verifikimit, Komisioni përgatit:
- a) një relacion, ku përshkruhen të dhënat që rezultojnë për çdo kandidat, në lidhje me plotësimin ose jo të kushteve dhe kritereve formale të kandidimit, duke i bashkëlidhur listat për çdo kategori;
 - b) projektvendimin përkatës të verifikimit.
42. Kryetari i komisionit i dërgon Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit relacionin sipas propozimeve të komisionit.
43. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit miraton relacionin për verifikimin e kandidatëve sipas propozimit të Komisionit ose me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtarit.
44. Vendimi i verifikimit arsyetohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ.
45. Vendimi i verifikimit i njoftohet kandidatit sipas kërkesave të nenit 147 të Kodit të Procedurave Administrative lidhur me mënyrën e njoftimit.
46. Ndaj vendimit të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për skualifikimin e kandidatit, ky i fundit mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda 15 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
47. Vendimi i Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për përfundimin e procedurës së kandidimit për kandidatin që tërhiqet nga kandidimi, është i paankimueshëm
48. Në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit publikohet lista e kandidatëve të kualifikuar dhe ajo e kandidatëve të skualifikuar.

Ky urdhër hyn në fuqi pas publikimit në faqen zyrtare të Avokaturës së Shtetit.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHETIT

ODISE MOÇKA

